

V E N D I M
Nr.758, datë 11.11.1996

PËR PROCEDURAT KRYESORE TË PRIVATIZIMIT TË SHOQËRIVE STRATEGJIKE

Në mbështetje të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, me propozimin e Ministrisë së Privatizimeve, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ndërmarrjet ose njësitë e tjera shtetërore të degëve me rëndësi të veçantë të ekonomisë kombëtare, të cituara në ligjin nr.7512, datë 10.8.1991, neni 3 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, si dhe ndërmarrjet ose njësitë e tjera shtetërore të degëve me rëndësi të veçantë të ekonomisë kombëtare, të cilat mund të privatizohen në raste të veçanta me ligj, do të quhen “Shoqëri strategjike” dhe sektorët ku ato veprojnë “Sektorë strategjikë”.

2. Procedura e privatizimit të shoqërive strategjike do të përmbledhë:

A. Studimin e mundësisë së privatizimit të shoqërive strategjike.

B. Përgatitja e planit të privatizimit.

C. Miratimin e planit të privatizimit.

D. Shitjen dhe transferimin e aksioneve të shoqërive strategjike.

Shitja dhe transferimi i aksioneve të shoqërive do të bëhet me një nga format e mëposhtme:

- Transferim i aksioneve me ofertë publike.

- Transferim me ankand i aksioneve të shoqërisë.

- Transferim të aksioneve me negociim.

A. Përgatitja e studimit të mundësisë së privatizimit të shoqërive strategjike është detyrë e Ministrisë së Privatizimeve.

Përgatitja e studimit të mundësisë së privatizimit të shoqërive strategjike mund të bëhet me konsulencë të huaj. Ministria e Privatizimeve është përgjegjëse për përzgjedhjen e konsulencës së nevojshme për kryerjen e studimeve të mundësisë së privatizimit. Ministrinë e tjera dhe Departamenti Shtetëror i Postave dhe Telekomunikacioneve, të cilat administrojnë shoqëritë strategjike, vënë në dispozicion të procesit të privatizimit të gjitha të dhënat ekonomike, financiare, organizative si dhe personelin e nevojshëm për kryerjen e këtij studimi, duke iu përmbajtur afateve kohore të përcaktuara nga Ministria e Privatizimeve.

B. Plani i privatizimit do të përgatitet nga Ministria e Privatizimeve.

Plani i privatizimit mund të përgatitet me asistencën e konsulentëve financiarë dhe juridikë, të cilët mund të jenë të njëjtë me ata që kanë përgatitur studimin për mundësinë e privatizimit të shoqërisë strategjike.

Plani i privatizimit përmban të dhëna kryesore për:

- Kohën dhe metodën e privatizimit.

- Formën e realizimit të shitjes ose të transferimit të aksioneve.

- Kriteret e përzgjedhjes e të vlerësimit të blerësve potencialë.

- Detajet e publikimit.

C. Miratimi i planit të privatizimit do të bëhet nga Ministria e Privatizimeve dhe ministrinë e tjera, si dhe Departamenti Shtetëror i Postave dhe Telekomunikacioneve.

Në rast se të dy ministrinë e mësipërme bien dakord, ky plan hyn në fuqi dhe duhet të zbatohet nën drejtimin e Ministrisë së Privatizimeve. Në rast të kundërt plani do të miratohet nga bordi i ministrave i ngritur për këtë qëllim.

Bordi i ministrave do të përbëhet nga:

- Kryeministri

- Ministri i Privatizimeve

- Ministri i Financave

- Ministri i Burimeve Minerare dhe Energjetike

- Ministri i Rregullimit të Territorit dhe Turizmit

- Ministri i Industrisë, Transportit dhe Tregtisë
- Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit

D. Transferimi i aksioneve me ofertë publike dhe transferimi me ankand i aksioneve të shoqërive do të bëhet nga Ministria e Privatizimeve.

Akti i transferimit të aksioneve do të kryhet nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit.

Negocimi për transferimin e aksioneve të shoqërive strategjike do të bëhet nga komisioni i përbashkët që krijohet nga Ministria e Privatizimeve dhe ministrinë e tjera, Departamenti Shtetëror i Postave dhe i Telekomunikacioneve, sipas përkatësisë së administrimit të pronës shtetërore. Komisioni përbëhet nga pesë anëtarë, ku tre prej tyre do të caktohen nga Ministria e Privatizimeve dhe dy të tjerë nga ministrinë e tjera dhe Departamenti Shtetëror i Postave dhe Telekomunikacioneve. Komisioni mund të asistohet nga konsulentë të specializuar në sektorin që privatizohet.

Hartimi i kontratës së shitjes dhe nënshkrimi i saj për të gjitha rastet do të bëhet nga Ministria e Privatizimeve. Për këtë qëllim mund të përdoret konsulenca e huaj.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi